



TRIBUNA

REVISTË MUJORE MBI TRANSPARENCËN DHE LLOGARIDHËNIEN NË
INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE TË KOSOVËS

TETOR, 2020

SINDIKALE

- Kryetarja e Forumit Rinor të FSSHK-së znj. Hanushe Llabjani merr pjesë në Webinar-in e organizuar nga ESPU dhe Amnesty International
- Takim i Kryetarit të FSSHK-së Dr. Blerim Sylja me Ambasadorin e OSBE-së në Kosovë Zt. Jan Braathu
- Punëtorët e IKSHPK-së marrin shpërblimet Jubilare bazuar në Kontratën Kollektive Sektoriale
- Pranohet ankesa e FSSHK-së nga Instituti i Avokatit të Popullit
- FSSHK dhe SHSKUK diskutojnë për zbatim të vendimit të qeverisë

Arrihet marrëveshja ndërmjet FSSHK-së dhe Qeverisë së Kosovës për pagesat shtesë deri në fund të këtij vitit



Dëgjimi publik për Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës
fq.8-9

Ky botim është financuar nga ana e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës

Arrihet marrëveshja ndërmjet FSSHK-së dhe Qeverisë së Kosovës për pagesat shtesë deri në fund të këtij vitit



Me datë 29 tetor 2020, Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, Ministri i Shëndetësisë, z. Armend Zemaj dhe përfaqësuesit e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë të Kosovës (FSSHK), të udhëhequr nga Kryetari Dr. Blerim Sylja, së bashku me nënkryetarët Mr. Blerim Delija dhe Dr. Xhemajl Selmani, u pajtuan për pagesat shtesë për të punësuarit në institucionet publike shëndetësore të Republikës së Kosovës, në sistemin primar, sekondar dhe terciar, deri në fund të vitit 2020, bazuar në Ligjin AntiCovid.

Duke marrë në konsideratë mundësitë financiare që Qeveria e Republikës së Kosovës ka në këtë periudhë, për të mbështetur të punësuarit në sistemin publik shëndetësorë, palët u morën vesh që pagesat shtesë për muajit shtator-dhjetor të jenë si në vijim:

1. Mjekët – 250 euro në muaj,
2. Infermierët – 150 euro në muaj,
3. Stafi mbështetës – 100 euro në muaj.


Kryeministri Hoti është zotuar se Qeveria në afat shumë të shkurtër kohor do të kryej edhe pagesat shtesë për stafin mbështetës, për muajit korrik dhe gusht të këtij viti.

Palët po ashtu janë dakorduar që në fillim të viti të ardhshëm, të diskutohen mundësitë për pagesat shtesë për kohën sa do të zgjasë pandemia me Covid 19, në territorin e Kosovës.

TRIBUNA sindikale

“Ky botim është realizuar nga ana e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e ekskluzive e FSSHK-së.”

Kryetarja e Forumit Rinor të FSSHK-së znj. Hanushe Llabjani merr pjesë në Webinar-in e organizuar nga ESPU dhe Amnesty International



Ndërsa vala e dytë e COVID-19 po godet, një gjë është e qartë: Duartrokitjet për punonjësit e kujdesit shëndetësor nuk janë të mjaftueshme. Punëtorët meritojnë më shumë. Seminar online i organizuar nga ESPU dhe Amnesty international për të ardhmen e shëndetit dhe kujdesit shoqëror.

Në këtë seminar online ka qenë pjesë e panelit edhe Kryetarja e Forumit Rinor të FSSHK-së ku ka prezentuar situatën me Pandemin në Kosovë.

Për sfidat kryesore për menaxhimin e pandemisë në Kosovë, si dhe gjendjen nëpër klinika dhe spitale rajonale dhe më e rëndësishmja roli i Sindikatë gjatë Pandemisë.

Përhapja e COVID-19 në Kosovë ka sjellë shumë sfida; frikë për jetën e tyre për punonjësit e kujdesit shëndetësor për shkak të kushteve të pasigurta të punës.

Ashtu si shumica e vendeve në botë, Kosova përballet me dyshimin e qytetarëve për ekzistencën e virusit, si dhe mungesën e bindjes së tyre për të i'u përmbajtur masave dhe rekomandimeve.

Për këtë arsye Qeveria është detyruar të bëjë një ligj Anti-Covid i cili është miratuar në Kuvend. Tani me këtë ligj mbajtja e maskës jashtë shtëpisë është bërë e detyrueshme.

Profesionistët shëndetësorë si dhe përgjegjësit tjerë të institucioneve vazhdimisht bëjnë thirrje dhe fushata të ndryshme për respektimin e mbajtjes së maskës, distancës fizike, dhe higjienës, si tre komponentët kryesore për parandalimin e sëmundjes Covid-19.

Numri i reduktuar i stafit shëndetësor nëpër klinika dhe reparte ka ndikuar në shtimin e vëllimit të punës dhe në mbingarkesë të punëtorëve shëndetësor, ndërsa gjatë këtyre 8 muajve punëtorët shëndetësor i ju është lejuar që të marrin pushimin 5ditë pune si dhe shpesh kanë punuar me orar të stërzgatura 12-24 orë shërbim.

Pandemia ka shkaktuar një pasiguri dhe një frikë të madhe tek punëtorët shëndetësorë, si pasojë e kushteve jo të mira të punës. Ky lloj ndryshimi është i vështirë për çdo shërbim shëndetësor.

Ata duhet të ndryshojnë mënyrën se si mendojnë dhe veprojnë, një ndryshim të plotë të qasjes.

Përveç kësaj, një faktor kryesor në Pandeminë është numri i lartë i pacientëve që mbërrijnë në spitale të gjithë në të njëjtën kohë.

Gjendja në Spitalet e Kosovës gjatë Pandemisë COVID-19

Në Kosovë janë 7 Spitale Regjionale, 1 Qendër Klinike Universtare dhe 38 qendra kryesore të mjekësisë familjare.

Pandemia COVID-19 i ka gjetur të pa përgatitura po thuajse të gjitha institucionet publike shëndetësore por edhe ato private, spitalet kanë raportuar për mungesë të respiratoreve, terapisë me oksigjen dhe mungesës së barnave të dedikuara për trajtim të COVID-19, në përgjithësi fillim ka qenë me shume improvizim dhe përshtatje me kushtet aktuale, por pas rënjes së rasteve me COVID-19 insitucionet u mobilizuan duke krijuar reparte të ndara për COVID 19.

Nga marrja masave një pjesë e stafit janë liruar nga puna(punëtoreset mbi 60 vjet,punëtoreset me semundje kronike dhe nënat veteushqyese) por jane reduktuar edhe shërbimet në sistemi shëndetësor, duke punuar vetem në trajtimin e rasteve emergjente.

Kjo mund të ketë një ndikim negativ edhe në sistemet e kujdesit shëndetësor të mirë zhvilluara, të cilat nuk janë mësuar të përballen me këtë vëllim pune në baza ditore.

Përshtatja me këtë situatë ishte sfiduese dhe e vështirë edhe për ne.

Gjatë periudhës 8 mujore numri i përgjithshëm i punëtorëve shëndetësor të infektuar ka kaluar mbi 15% të numrit total të të punësuarve në shëndetësi dhe janë regjistruar 14raste të vdekjëve të punëtorëve shëndetësore që humben bejtejn kunder covid-19,për qytetarët e Kosovës ka qenë humbja më e madhe sepse ata ishin në vijën e parë të fronit.

Aktualisht në Spitalet e Kosovës po trajtohen mbi 200 pacientë me Covid, dhe rreth 60-70 për qind e tyre janë duke u trajtuar me oksigjeno terapi.

Gjatë muajit tetor janë shtuar kapacitetet testuese, tani Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik kryen mbi 1 mijë teste brenda 24 orëve dhe është rritur numri i infermierëve në klinikat dhe spitalet Covid-19.

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë faktor kyq gjatë Pandemisë COVID-19

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës në takimin me Ministrin e Shëndetësisë ka ofruar të gjitha potencialet e veta si kuadro profesionale dhe monitorim të gjendjës dhe sigurisë në punë të punëtorëve shëndetësor, gjithashtu ka qenë aktive gjatë kësaj kohe në monitorim të kushteve të punës së punëtorëve shëndetësor përmes komunikimit në media, intervistave dhe emisioneve televizive,duke potencuar rëndësinë e punëtorëve shëndetësor.

Kërkesat nga ana e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës kanë qenë ;

- 1.Furnizimi me material dhe pajisje mbrojtëse të cilat kanë munguar në shumë instutucione shëndetësore,
- 2.Stimulimi i të gjithë punëtorëve shëndetësorë duke përfshirë edhe stafin mbështetës,
3. Kërkesë për mosdiskrimimin të punëtorëve shëndetësorë dhe stafit mbështetës për stimulim.
- 4.Të bëhen testime brenda instutucioneve shëndetësore, duke pasur parasysh se rreziku
- 5.Është shumë i lartë sepse mosha mesatare e personelit shëndetësorë momental është 53 vjeç.

Duke e parë gjendjen e renduar me material funizuese nga ana e Ministrise se Shëndetësisë gjatë periudhës prill-maj FSSHK- ka shpërndar donacionin të ndryshme se bashku me organizatat partnere, gjithashtu ka marrur vendim qe të ju dal në ndihmë punëtorëve shëndetësor nga fondi i Sindikatës, ku perveç anëtarëve nga ndihma e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë kanë përfituar edhe jo anëtarët duke ju dërguar ushqime në pika kufitare, si dhe pajisje mbrojtëse (maska, dorza).

Fsshk- vazhdon ti përkrah punëtorët shëndetësor të infektuar me COVID-19 me shume simbolike prej 50 euro. Sindikata vazhdon të ju bejë thirrje institucioneve relevante për krijimin e kushteve të punës për valen e dytë, e cila mund të jetë një kërcënim i madh për stafin shëndetësor.

Është e rëndësishme të përmendet se Kryetari i Sindikatës së Federatës Shëndetësore të Kosovës kishte takime të rregullta me përfaqësues të institucioneve të vendit, gjithashtu kishte një takim me Ambasadorin OSBE mbi situatën të punonjësve shëndetësorë ku ranë dakord që në të ardhmen ata do të vazhdojnë të bashkëpunojnë për m ë mirë të punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe të gjithë sistemit.

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës zgjatë dorë te anëtarësitë e saj



Me datë 24 Prill, Me iniciativën e Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Sylja, duke parë situatën e krijuar nga Pandemia COVID-19, numrin e të infektuarve në mesin e tyre edhe numrin në rritje të punëtorëve shëndetësor , Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka shpreh nevojën për ti dal në ndihmë punëtorëve shëndetësor të infektuar me pako ushqimore-higjienike nga ana e Federatës. Andaj kryesia e Federatës ka marrë vendim në mënyrë unanim në lidhje me përkrahjen financiare për të gjithë punëtorët shëndetësor dhe stafin mbështetës (anëtarë të FSSHK-së) të testuar pozitiv me virusin COVID-19 në shumën prej 50.00 euro, sipas kriterëve të përcaktuar nga Komisioni i formuar nga Kryetari i FSSHK-së Dr.Blerim Sylja për verifikim të dokumentave të punëtorëve të shëndetësor.

Që nga fillimi i Pandemisë e deri më tani numri i përfituesëve të kësaj shumë është mbi 680 punëtorë në të gjitha Institucionet Shëndetësor duke përfshirë mjekësin primare, sekondare dhe terciare. Vlenë të theksohet se punëtorë të cilët kanë kaluar në këto periudhë të vështirë kanë qenë shumë mirënjohës për ndihmë e afruar dhe përkrahjen morale dhe institucionale të Federatës.

Federata nuk është ndalur me kaq, po me propozim të Kryetarit të FSSHK-së Dr.Blerim Sylja, anëtarët të Kryesisë së FSSHK-së kanë marrë vendim që për punëtorët shëndetësor të cilët punojnë në pika kufitare të sigurohet Ushqim dhe Transport, të cilët janë angazhuar nga Komunitet e Kosovës, punëtorët shëndetësor për të ndihmuar qytetarët në senzibilizim, parandalim dhe përcjellje të gjendjes së të infektuarve me Covid-19, ku shumica e komunave kanë të ngritura tenda për pranim të qytetarëve në të cilat kanë angazhuar stafin e QKMF-ve dhe ekipet në terren- pika kufitare, si nga QKMF- Skenderaj, QKMF- Deqan, QKMF-Klinë ,QKMF-Mitrovicë , QKMF-Vushtrri, QKMF-Podujevë,QKMF- Dragash, QKMF-Ferizaj,QKMF- Prizren, QKMF-Suharek dhe QKMF-Prishtinë.

Punëtorët shëndetësor kanë dhënë kontributin e tyre në pikat kufitare të Kosovës varësisht nga pozita gjeografike dhe rajoni në të cilin gjenden.

Kjo edhe një herë dëshmon se punëtorët shëndetësor janë në nivel të detyrës për të ofruar shërbime shëndetësore sa më cilësore të pacientët , duke rrezikuar edhe shëndetin, vetëm e vetëm për të tejkaluar këtë gjendje të Pandemisë, përkundër vështirësive që mund të kenë pasur ato.

Yllka Krasniqi

Takim i Kryetarit të Fsshk-së Dr.Blerim Syla me Ambasadorin e OSBE-së në Kosovë Zt.Jan Braathu



Në përpjekjet e vazhdueshme për të drejtat e puntorëve shëndetësor, me datë 12.08.2020 Kryetari i FSSHK-së dr.Blerim Syla ka zhvilluar takim me ambasadorin e OSBE-së në Kosovë, shkëlqesinë e tij Zt.Jan Braathu. Gjatë takimi Kryetar i FSSHK-së Dr. Syla e informoi Ambasadorin Braathu për situatën e vështirë me të cilën përballen mjekët, infermierët dhe personeli ndihmës i institucioneve shëndetësore si dhe sfidat e sistemit shëndetësor në këtë kohë Pandemie. Ai nënvizoi në veçanti mungesën e stafit në Institucione shëndetësore me theks të veçantë në Klinka, Spitale dhe QMF, për të cilën tha se është bërë akute që nga shpërthimi i Pandemis COVID-19.

Ambasadori Braathu e falënderoi Dr. Sylën për informimin rreth qëndrimeve të Federatës në mbështetje të Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19, që aktualisht gjendet në Kuvendin e Kosovës.

Ambasadori Zt.Braathu theksoi rëndësinë e sindikatave si shtyllë kryesore e shoqërisë civile, duke thënë se, "Është e rëndësishme që profesioni mjekësor e ka një zë dhe ai zë duhet të dëgjohet."

Palët u dakorduan se edhe në të ardhmen të bashkëpunojnë në të mirë të punëtorëve shëndetësor dhe sistemit në tërësi.

Në fund Kryetar i FSSHK-së Dr.Syla shprehi falenderimet e singerta në emër të gjithë punëtorëve shëndetësore ambasadorin Zt.Jan Braathu.

Yllka Krasniqi

FSSHK-së i bashkohen punëtorët shëndetësor dhe stafin mbështetës të Institutit të Mjekësisë Ligjore

Kryetari i FSSHK-së dr.Blerim Syla, Nënkryetari i FSSHK-së Mr.Blerim Delija dhe Zyrtarët Ligjore të FSSHK-së Nora Murataj dhe Zana Morina kanë zhvilluar takim me disa përfaqësues të punëtorëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore (IMK-së). Kryetari i FSSHK-së dr. Blerim Syla i ka njoftuar të pranishmit me punën dhe aktivitetin e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës.

Punëtorët e IML-së vlerësuan lartë punën e Federatës dhe shprehën interesimin e tyre për tu anëtarësuar në mënyrë kolektive në FSSHK. Kryetar i FSSHK-së dr. Blerim Syla përshëndeti këtë qëndrim të punëtorëve dhe i siguroj se me anëtarësim në FSSHK do të gëzojnë të gjitha të drejta të cilat burojnë nga Kontrata Kolektive Sektoriale, Statuti, Rregulloret e FSSHK-së si dhe marrëveshjet me subjektet afariste.

Palët u dakorduan që më kërkesë të punëtorëve të formohet strukturat udhëheqëse të Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore, Kryetari i FSSHK-së Dr.Blerim Syla në koordinim me Komision qëndror zgjedhor konkretisht me Kryetarin e Komisionit Mr.Blerim Delija dhe anëtarët e KQZ-së kanë vendosur që të legjitimoj Kryesinë e Sindikatës së IML-së në këtë përbërje si: Kryetari i Sindikatës të IML-së Mr.Ph. Nardi Sheqerxhiu, Nënkryetar i Sindikatës MA. Bedri Zhegrova, Kryetare e Forumit të Gruas BA.Venera Mehmeti, Kryetar i Forumit të Rinisë BA.Mehdi Rama dhe Anëtarë të Kryesisë Dr.Islam Kryeziu.

Kryetari i FSSHK-së Dr.Blerim Syla ka trajtuar me prioritet këto shqetësime të punëtorëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe ka realizuar takim me datë 01 tetor 2020 me Ministrin e Drejtësisë Zt.Selim Selimi, si bashku me Kryetarin e Sindikatës të IML-së Z.Nardi Sheqerxhiu, Nënkryetar i Sindikatës Z.Bedri Zhegrova, dhe zyrtaret Ligjore të Sindikatës së QKUK-së Zana Morina.



Ku është njoftuar për së afërmi Minsitri Z.Selimi me shqetësimin e punëtorëve të IML-së në lidhje me Rregullorën 01/20 të organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore, në fund të takimit është arritur që të formohet grupi punëse për plotësim ndryshimin të rregullorës në fjal ku pjesë e këtij grupi punës do të jetë edhe Përfaqësuesi nga FSSHK-Sindikata të IML-së. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovë është lidere në përfaqësimin e punëtorëve, duke i mbrojtur dhe në avancimin të drejtave të punëtorëve shëndetësor në nivel vendi.

Dëgjimi publik për Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës



Me datë 10.08.2020 Kryetari i FSSHK-së Dr.Blerim Syla ka marr pjesë në dëgjimin publik të Projektligjit për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, me ftesë të Kryetares së Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Dr.Albena Reshitaj, ku ka paraqitur kërkesat e FSSHK-së në lidhje me këtë Ligj.

Fjalim i Kryetari të FSSHK-së Dr.Blerim Syla: Fillimisht më lejoni të shprehi ngushllime më të sinqerta të cilët kanë humbur më të dashurit e tyre gjatë kësaj periudhe të Pandemie, posaqërisht 5 kolegëve tanë të cilët e humbën betejën tonë, ndërsa Juve të cilët kanë kalura këtë betejë me Covid-19 shëndet për gjithë Juve dhe familjet e Juaja, të tjerëve ju dëshirojmë shërim sa më të shpejt.

Po fillojmë me numrat jo të mirë të të infektuarëve të punëtorëve shëndetësor siç e dini ai numër është arritur dikun 1000, duke pasur se sa pak jemi ne punëtorë shëndetësor dhe nuk kemi qenë të përgaditur me këtë betejë është me të vërtetë situata alarmante, ne si Federatë vazhdimisht kemi apeluar që të bëhet diçka në lidhje më të, dhe në kuadër të saj neve e përshëndesim Ligjin, por çka dëshirojmë është që ky Ligji të jetë shumë i kjarët sa i përket edhe kompetencave të Ministrisë Shëndetësisë por edhe ajo çka ne insistojmë si Federatë e Sindikatave të Shëndetësisë që të jetë shumë i kjarët se ku e kanë vendin e vetë më në fund punëtorët shëndetësor, se neve vetëm bëjmë Ligji që sa më thënë po e bëjmë këtë Ligj atëherë nuk është mirë ndoshta në opinion, unë mendoj që është mirë të dilet edhe Ju si komisioni me një kosto financiare se sa do të kushton ky Ligj, cilat do të jeni ato stimulime dhe jam kundër asaj ndoshta po gaboj për ata të cilët janë direkt në ballafaqim më Covid-19 nuk ka më për ata tash të gjithë punëtorët shëndetësor janë në ballafaqim direkt me Covid -19 d.m.th nuk kemi dallim tashti , po i shihni kapacitete në vazhdimësi po duhet të zgjerohemi edhe nepër disa klinika të cilat as që kanë lidhje më to, andaj konsideroj që aty nuk kemi një ndarje dhe nuk guxon me qenë, mundet më qenë një shkallëzim, mundet më qenë një benificion pak më shumë për ata që direkt ballafaqohen por të gjithë punëtorët shëndetësor duhet të përfshihen.



Ndoshta ekspertët kishin më na ndihmuar në dy çështje që unë si Kryetar i FSSHK-së jamë ballafaqu shumë edhe për ofendime ky Ligj duhet të parashoh edhe sanksion për ata njerzë të cilët shpërndajn dezinformata, dezinformojn popullatën hapin defektizëm se nuk egziston virusi dhe si pasoj e dezinformatave të tilla, unë besoj që edhe mediat mjaft kanë një demokraci të brishtë si pasoj e kësaj e kemi situatën se 30% e popullatës deklarojnë se nuk ka virus deri në momentin kur ballafaqohet dikush me këtë realitet andaj me njerëzit e tillë, nëse nuk kanë fakte duhet të merret dikush sepse gjithë këtë punë po e lanë punëtori shëndetësor e aq ma keq po pësojnë edhe popullata e jonë.

Një ndër propozimet duke u nisur nga numri shumë i madh i punëtorëve shëndetësor të infektuar të cilën unë e argumentova tash më kjo të konsiderohet edhe sëmundje profesionale ju jeni ka e shihni që secili punëtorë shëndetësor sot ballafaqohet, vetëm një gjë po ju them këtu prezent është edhe Kryetari i Odës së Fizioterapeutëve, edhe pse direkt nuk janë marrë me pacientë me Covid-19 brenda ditë kanë dal dikun 9 punëtorë të infektuar andaj duke u marr nga këto unë konsideroj që duhet të kenë në konsideratë edhe Prof.Naser Ramadani nga IKSHPK-ja dhe gjitha këto Institucione, unë kam edhe një dokument nga Rumania të cilën nuk kam arritur që të përkthej se vetëm kanë përfunduar negociatat mes Kryeministrit atje besoj që është një shembull i mirë që faktikisht kjo të konsiderohet si sëmundje profesionale, dhe në kuadër të saj pasi Ligji i Pagave është shfuqizuar dhe pasi që nuk po kalon asnjë propozim dhe amandament për të mirën e punëtorit shëndetësor atëherë insisto që në këtë Ligj me të vërtetë të shihen shtesa për punëtorët shëndetësor SHTESA MBI PAGË edhe një herë jo stimulim por shtesa mbi pagën derisa sa të vjen Ligji i ri i pagave, lëmoshë nuk po kërkon askush këtu, por po kërkojmë një diçka e cila kishte më na mundësuar neve të merremi me punë profesionale dhe jo të pregadisim protesta në fazën se ç'farë jemi ne.

Për fund edhe njëherë ju falenderoj për kohë dhe mundësinë që na keni dhënë do të mundohem të dërgojmë në mënyrë elektronike komentet tona që të jemi sa më konstruktiv por po ju paralajmëroj dhe po insisto se ne sa po kemi dal nga takimi me Ministrin e Shëndetësisë, por ky Ligji do të na rregulloj mirëqenien dhe do të fillojnë të na ruajnë integritetin dhe dinjitetin tonë. Faleminderit.

Yllka Krasniqi

Pranohet ankesa e FSSHK-së nga Instituti i Avokatit të Popullit

Pranohet si e bazuar Ankesa për diskriminim mbi kompensimin në Pagë të punëtorëve shëndetësor me Vendim të Qeverisë, të paraqitur me 28/09/2020 nga Instituti i Avokatit të Populli.



Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës nga data 14 deri me datë 18 Shtator 2020 ka organizuar Peticion të cilit i janë përgjigjur stafi mbështetës i Institucioneve publike shëndetësore por edhe punëtorët shëndetësor të tyre. FSSHK-ë me anë të kësaj ka shpreh revoltën dhe indinjatën e saj duke shprehur që Qeveria të reflekton në mbarë teritorin e Republikës së Kosovës apo në të kundërtën jemi të detyruar që të ndërmarrim hapa të tjerë sindikal. Qëllimi i këtij Peticioni është shprehja e pakënaqësisë në lidhje me mos realizimin e pagesës prej 300.00 euro bazuar në Vendimin e Qeverisë me nr. 05/18 të datës 29.07.2020 të cilin përmes ankesës me nr.466/2020 të datës 06.08/2020 e kemi adresuar në Institucionit të Avokatit të Popullit dhe me datë 17.08.2020 FSSHK është njoftuar se IAP ka pranuar ankesën për hetimin e shkeljeve eventuale të pohuara.

Në vazhdës e kësaj me datë 21 tetor 2020, Delegacion nga FSSHK-ja i kryesuar nga Kryetari i FSSHK-së Dr.Blerim Syla dhe Zyrtarja Ligjore e FSSHK-së Nora Murataj kanë zhvilluar takim me Këshilltarën Juridike të Institucionit të Avokatit të Popullit Znj.Dragana Rodiq ku janë dorëzuar dokumenta shtesë për shqyrtimi në lëndës dhe Peticion i punëtorëve shëndetësor dhe stafit mbështetës. Me kërkesë të Përfaqësuesit të IAP është ndarë lënda dhe është bërë Ankesë e veçant në lidhje me diskriminimin mbi kompensimin në pagë të punëtorëve shëndetësor me Vendim të Qeverisë nr. 05/18 të datës 29.07.2020.

Këshilltarja e Institucionin e Avokatit të Popullit Znj.Radiq është njoftuar me punën dhe aktivitet e FSSHK ka janë dërguar katër(4) shkresa me të njejtin qëllim, por deri më tani nuk kemi marr asnjë përgjigje nga Kryeministri i Republikës së Kosovës Z.Avdulla Hoti, andaj duke qenë se FSSHK-ë ka marrë ankesa të njëpasnjëshme nga punëtorët shëndetësor dhe stafi mbështetës duke filluar nga Qendra Klinike Universitare, Spitalet e Përgjithshme, Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare të udhëhequra nga Komunitat, jemi drejtuar Institucioneve relevante që ta kanë parasysh kërkesën tonë.

Vendimi i nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës përveq se ka bërë ndarje në mes të punëtorëve shëndetësor dhe stafi mbështetës, ne vlerësojmë se kemi bazë edhe për diskriminim sepse paragrafi 1.2 me nënparagrafët 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij Vendimi nuk janë zbatuar nga ana e insitucioneve shëndetësore respektivisht Ministria e Shëndetësisë në ndarje të këtyre mjeteve. Ne konsiderojmë se të gjithë punëtorët shëndetësor dhe stafi mbështetës aktiv në punë gjatë kësaj kohe gjejjësisht nga fillimi i Pandemisë kanë qenë dhe janë të rrezikuar nga infeksionin COVID-19, nuk mund të ketë përjashtime si psh, pagesën shtesë ta merr mjeku ose infermieri kurse punëtori i higjenës apo i kuzhinës mos të përfitojë.

Rastet konkrete të diskriminimit mund të gjenden në të gjitha institucionet shëndetësore në të gjitha nivelet, ne mund të konsiderojmë dy lloje të diskriminimit të tërthortë atë kur për punën e njëjtë të kryer nuk janë trajtuar barabartë(kanë përfituar shtesë punëtorët shëndetësor që kanë qenë të liruar nga puna sipas Vendimit të Qeverisë, kanë përfituar shtesë punëtorët pa i plotësuar kriteret për përfitimi të shtesës në pagë) dhe diskriminimin në baza ekonomike sociale në bazë të pozitës së punës ku të punësuarit me status më të ulët sikurse punëtorët e higjenës, punëtorët e sigurimit, vozitësit e autoambulancave dhe pozita të ngjajshme janë diskriminuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Pas reagimeve të FSSHK-së të adresuar Institucionit të Avokatit të Populli, me datë 12 tetor 2020 kemi marrë njoftimin nga Instituti i Avokatit të Popullit se në bazë të neni 21.1. të Ligjit për Avokatin e Popullit është shqyrtuar Ankesa për diskriminim mbi kompensimin në pagë të punëtorëve shëndetësor me Vendim të Qeverisë, të paraqitur me 28/09/2020, lidhur me pohimin për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut apo keqpërdorim nga autoritetet publike dhe në pajtim me nenin 21.1.2 të **Ligjit për Avokatin e Popullit, ka vendosur si të pranuar ankesën për hetimin e shkeljeve eventuale të pohuara.**

Andaj Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës nuk do ti ndal veprimet deri në arritjen e vendimit meritator për të gjithë profesionistët shëndetësor dhe stafin mbështetës në sektorin e shëndetësisë.

Yllka Krasniqi

Punëtorët e IKSHPK-së marrin shpërblimet Jubilare bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale



Me iniciative të lirë dhe me anë të pajtimit të vullneteve është arritur të nënshkruhet Kontrata Kolektive Sektoriale në mes Ministri i Shëndetësisë z. Uran Ismaili dhe Kryetarit të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës Dr. Blerim Sylja me datë 11.06.2018

Në këtë kontratë janë paraparë të drejta më të zgjeruara dhe beneficione në shtesa të pagës për anëtarët e FSSHK-ës, të cilët njëherit janë edhe punëtor të institucioneve shëndetësore, me theks të veçantë nën titullin 17 i KKS-së paragrafi 3 me nënparagrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3 si dhe paragrafi 4 i tij i cili citoj: "Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore për 10 vjet të përvojës në punë, në vlerë të dy pagave mujore për 20 vjet të përvojës në punë, në vlerë të tri pagave mujore për 30 vjet të përvojës në punë". Kontrata Kolektive Sektoriale e nënshkruar në Qershor të vitit 2018 ka hyr në fuqi në momentin e nënshkrimit andaj Insitucionet shëndetësore të të tri niveleve të sistemit shëndetësor duke përfshirë edhe institucionin janë të obliguar të zbatojnë.

Me qëllim të ruajtjes së marrëdhënie të mira ndërkolegiale por duke i ditur edhe limitet buxhetore me të cilat ballafaqohet institucioni shëndetësor Federata ka pritur deri më shtator 2020 që të gjindet forma e pagesës dhe ndarja e buxhetit për kompenzimin e shpërblimeve jubilarë, meqë nuk është treguar vullnet për të zbatuar një të drejtë e tillë atëherë Kryetari i Sindikatës së IKSHPK-së Z.Vehbi Tahiri në bashkëpunim me zyrtaret e FSSHK-së Nora Murataj dhe Yllka Krasniqi kanë kompletuar dokumentacionin dhe janë adresuar instancave tjera ligjore siç është Inspektorati i Punës pas aprovimi të kërkesës dhe marrjes së vendimin pozitivë për punëtorët e IKSHPK-së duke ju falenderuar edhe Avokatit Sylejman Klinakut për angazhimin dhe Drejtorit të IKSHPK-së Dr.Naser Ramadani në koorrdinim dhe bashkëpunim me Kryetarin e FSSHK-së Dr.Blerim Sylja është arritur që të zbatohet vendimi i Inspektoratit të Punës dhe të gjithë punëtorët e IKSHPK-së (anëtarët e FSSHK-së) kanë përfituar pagat jubilarë varsisht prej përvojës së punës të cilën e kanë pasur.

Punëtorët shëndetësor kanë qenë shumë falenderues dhe mirënjohës për marrjen e shpërblimeve jubilarë e cila është arritur të zbatohet falë Kontratës Kolektive Sektoriale.

Yllka Krasniqi

Takim i Kryetarit të FSSHK-së me Zëvendësministrin e Shëndetësisë

Dr. Luan Gola



Me datë 01 shtator 2020, Kryetari i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka zhvilluar takim me Zëvendësministrin e Shëndetësisë Dr. Luan Gola. Gjatë takimit është biseduar për kategorizimin e shtesave për punëtorët shëndetësor, proces i cili ka përkrahjen e plotë të Ministrit Zemaj dhe Kryeministrit Hoti.

Po ashtu gjendja shëndetësore e stafit mjekësor gjatë pandemisë me COVID-19 mbetet preokupim i dyanshëm.

Palët u pajtuan që nga java e ardhshme FSSHK-ja do të monitorojë propozim ndryshimet e Ligjit për Shëndetësi.

Në fund Zëvendësministri, Kryetarin e FSSHK-së Dr. Blerim Sylën e falenderoj për korrektësi dhe bashkëpunim të hapur në këto momente nëpër të cilat po kalon vendi.

Mbesim të hapur në fuqizimin e bashkëpunimit dhe intensifikimin e Dialogut Social.

Yllka Krasniqi

Diskutohet për shtesat në pagë për punonjësit shëndetësorë



Me datë 31 gusht 2020, u realizua një takim i përbashkët mes ministrit të Shëndetësisë, Armend Zemaj, ushtruesit të detyrës së drejtorit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar, Valbon Krasniqi, dhe nënkryetarit të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë në Kosovë, Xhemajl Selmani, ku u diskutua përkitazi me çështjen për shtesën në paga për muajt korrik dhe gusht, për punëtorët shëndetësorë dhe stafin mbështetës.

Palët u pajtuan që të vazhdojnë përpjekjet për gjetjen e një zgjidhjeje, me qëllim që në lista të përfshihen të gjithë punëtorët shëndetësorë dhe stafi mbështetës, të angazhuar gjatë kohës së Pandemisë COVID-19.

Menaxhmenti i SHSKUK-së dhe Ministria e Shëndetësisë do të punojnë intensivisht në koordinim me Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë, për të përfshirë në listat për shtesën në paga të gjithë, pa dallim, përkundër buxhetit të limituar.

Yllka Krasniqi

FSSHK dhe ShSKUK diskutojnë për zbatim të vendimit të qeverisë



Kryetari i Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës Dr.Blerim Syla ka mbajtur takim pune me ushtruesin e detyrës së Drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Dr.Valbon Krasniqi.

Në takim është diskutuar në lidhje me zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për pagesën shtesë prej 300 eurove për punëtorët shëndetësorë, për muajin korrik dhe gusht.

Drejtori Krasniqi ka njoftuar drejtuesit e FSSHK-së, në lidhje me hapat që ka ndërmarrë ShSKUK, për zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ai bëri të ditur se ka formuar një komision, i cili do të punojë në këtë drejtim, për çka u pajtuan edhe drejtuesit e FSSHK-së.

Komisioni do të punojë ngushtë me drejtorët e klinikave të QKUK-së dhe njësitë tjera përbërëse të ShSKUK-së, me qëllim të eliminimit të keqkuptimeve dhe keqinterpretimeve.

Menaxhmenti i ShSKUK-së siguron të gjithë punëtorët se nuk ka dorëzuar listë me punëtorët, që ju takon kjo shtesë në ministritë përkatëse, deri në pëfundim të punës së komisionit.

Kërkohet nga Kryetarët e Sindikatave të QKMF-ve të kërkojnë nga Drejtorët e QKMF-ve nëpër Komuna që të veprohet njësoj si u.d. e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së Dr.Valbon Krasniqi.

Yllka Krasniqi



Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës
The trade Union Health Federation of Kosova
Sindikalna Federacija Zdravstva Kosova

Public Service International

Adresa: Rr. Musaft Kruja, V/17, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel&Fax: +381(0) 38 726-246, mob: +377(0) 45 588-902

Web: www.fsshk.eu, email: info@fsshk.eu

Ky botim është realizuar nga ana e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës FSSHK-së. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e FSSHK-së.

Na vizitoni www.fsshk.eu

Redaktori përgjegjës:
 Dr. Blerim Sylja-Kryetar i FSSHK
 Bashkëpunëtoreshë profesionale
 Nora Murataj